



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 340 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Sigma interalbenian vienna Insurance Group sh.a-Dega Kosovë-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Prising “sh.a -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi automjeteve ne pronësi të institucioneve të komunës së Drenasit – Ritender”, me nr. të prokurimit 611-19-3220-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –KK- Glllogoc, më datën: 25.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ Sigma interalbenian vienna Insurance Group sh.a-Dega Kosovë-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi automjeteve ne pronësi të institucioneve të komunës së Drenasit –Ritender”, me nr. të prokurimit 611-19-3220-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –KK- Glllogoc.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Sigurimi automjeteve ne pronësi të institucioneve të komunës së Drenasit –Ritender”, me nr. të prokurimit 611-19-3220-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –KK- Glllogoc, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Sigma interalbenian vienna Insurance Group sh.a-Dega Kosovë-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë: 17.05.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë: 29.05.2019

Data e hapjes se ofertave është bërë: 29.05.2019.

Data e përfundimit të rivlerësimit të ofertave është bërë: 07.06.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pasuksesshëm është bërë: 07.06.2019.

Data e vendimit të AK për dhënien e kontratës është bërë: 07.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë: 12.06.2019.

Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë: 13.06.2019.

Operatori ekonomik ankues “Sigma interalbenian vienna Insurance Group sh.a-Dega Kosovë-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 24.06.2019 me nr. 340/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi automjeteve në pronësi të institucioneve të komunës së Drenasit –Ritender”, me nr. të prokurimit 611-19-3220-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –KK- Glllogoc, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 56, nenin paragrafi 1.1 dhe 1.2, 59 paragrafi 4, dhe neni 60, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.06.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 05.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues konstaton :

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i OE ankues është se tek OE PRISIG SHA i cili është shpallur fitues janë evidentuar këto shkelje tek oferta e dhëne e sigurimit TPL për automjetet nga tabela PARAMASA PËR SIGURIMIN E AUTOMJETEVE për të cilën sipas specifikave Teknike është dashur të ofertohej.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
3	Tojota – me Rimorkio ngark. Max 1180kg	2779	1999	1630	COPE	1	TPL	179.36	538.08

OE për këto automjete ka ofruar me çmim njësi 179.26€, ndërsa bazuar në tarifat e miratuara nga BKQ për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

240.72€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjet me kategorinë mbi 1 deri 2 tone. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtese, po ashtu edhe është e cekur tek Specifika “EMERTIMI” e dhëna 1180kg.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emetimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
8	Renault	2200	2000	2315	COPE	1	TPL	184.08	552.24

OE për këto automjete ka ofruar me çmim për njësi 184.08€, ndërsa bazuar në tarifat miratuara nga BKQ për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

247.80€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë mbi 2701cm3. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtese.

Automjetet e QPS-së (Qendra për Punë Sociale)

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
1	Mitsubish	1100	2013	1003	COPE	1	TPL	87.32	261.96

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 87.32€, ndërsa bazuar ne tarifat e miratuara nga BKQ për këtë lloj automjet duhet te ofertohej si ne vijim:

100.30€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë 1101 deri 1300 cm3. Te dhënat teknike për këtë janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtese.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi ankimor duke u bazuar në tarifat për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë (TPL) Të aprovuara nga BQK-ja konstaton.

1 .Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin TOJOTA eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	Emërtimi	Cm3	Viti	Lloji sigurimit	Pesh/KG	Tarifat BQK	Çmimi ofruar nje vit	Diferenca	Përshkrimi
3	Tojota – me Rimorkio ngark Max 1180kg	2779	1999	TPL	1630	240.72	179.36	Minus -61.36	Është shkelur tarifa e BQK- së

Ky automjet hyn në kategorinë e grupit tarifar 2, ku automjeti në fjalë duhet të llogaritet me peshën në tonë tarifa 1deri 2 ton, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me një vlerë më të vogël minus -61.36 ku ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 2

Pesha në tonë		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	0,5	152.00	27.36	179.36
0,50	1	168.00	30.24	198.24
1	2	204.00	36.72	240.72
2	3	254.00	45.72	299.72
3	5	305.00	54.90	359.90
5	7	355.00	63.90	418.90
7	10	454.00	81.72	535.72
10	15	610.00	109.80	719.80
Mbi	15	760.00	136.80	896.80

2 .Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin RENAULT eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	Emërtimi	Cm3	Viti	Lloji	Pesh/KG	Tarifat e	Çmimi i ofr	Diferenca	përshkrimi
--	----------	-----	------	-------	---------	-----------	-------------	-----------	------------

				<i>sigurimi</i>		<i>BQK</i>	<i>për një vit</i>		
8	Renault	2200	2000	TPL	2315	247.80	184.08	-63.72	Nuk është respektuar tarifa e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifar 1, ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm3 tarifa mbi 2701, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ; prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

3 .Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin MITSUBISH eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Automjetet e QPS-së (Qendra për Punë Sociale)

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Tarifat e BQK</i>	<i>Çmimi ofruar</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Përshkrimi</i>
1	MITSUBISH	1100	2013	TPL	1003	100.30	87.32	-12.98	Nuk ka respektuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifar 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm3 tarifa 1101 deri 1300, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit	Primi neto	TVSH 18%	Primi
----------------------	------------	----------	-------

cm ³ ; prej-deri				bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

Prandaj duke u bazuar ne llogaritjet dhe sqarimet me lartë eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE SCARDIAN JSC i cili është klasifikuar si tenderues i pasuksesshëm janë evidentuar këto shkelje tek oferta e dhëne për sigurimet TPL për automjetet nga tabela PARAMASA PER SIGURIMIN E AUTOMJETEVE për të cilët sidomos specifikave Teknike është dashur të ofertohej.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
5	Autoambulanca Pegueot	2198	2012	1885	COPE	1	TPL	108.56	108.56

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 108.56€, ndërsa bazuar ne tarifat e miratuara NGA BQK për këtë lloj automjet duhet te ofertohej si ne vijim:

184.08€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjet me kategori 1951cm³ deri 2250cm³.

Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi ankimor duke u bazuar ne tarifat për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë (TPL) Të aprovuara nga BQK-ja jep sqarimet ne vijim

Sa i përket pretendimit të OE ankues për automjetin Autoambulanca Peugeot eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimi</i>	<i>Pesh/KC</i>	<i>Tarifat e BQK</i>	<i>Çmimi i ofruar për një vit</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Përshkrimi</i>
1	Autoambulanca Peugeot	2198	2012	TPL	1885	184.08	108.56	Minus -75.52	Nuk është respektuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn në kategorinë e grupit tarifar 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm³ tarifa 1951 deri 2250, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me një çmim me të ulët prej -75.52 euro ku ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit cm ³ prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

Prandaj duke u bazuar në llogaritjet dhe sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është **i bazuar**.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE SIGKOS SHA i cili është klasifikuar si tenderues i pasuksesshëm janë evidentuar këto shkelje tek oferta e dhënë për sigurimet TPL për automjetet nga tabela PARAMASA PËR SIGURIMIN E AUTOMJETEVE për të cilin sipas specifikave teknike është dashur të ofertuar.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
3	Tojota- me Rimorkio ngark. Max 1180kg	2779	1999	1630	COPE	1	TPL	247.80	743.40

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 247.80€, ndërsa bazuar në tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

240.72€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë mbi 1 deri 2 tone. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
8	Renault	2200	2000	2315	COPE	1	TPL	184.08	552.24

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 184.08€, ndërsa bazuar në tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

247.80€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë prej 2701cm3. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
9	Mercedes	2200	2000	2790	COPE	1	TPL	212.40	637.20

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 212.40€, ndërsa bazuar në tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

184.08€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë prej 1951cm3 deri 2250cm3.

Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit e ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Automjetet e QPS-së (Qendra për punë sociale)

	<i>Përshkrimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
1	Mitsubish	1100	2013	1003	COPE	1	TPL	87.32	261.96

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 87.32€, ndërsa bazuar në tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

100.30 me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë 1101 deri 1300cm³. Të dhënat teknike janë konfirmuara nga librezja e automjetit të ofruar nga AK si sqarime shtesë.

VEREJTJE: NE DOSJE TË TENDERIT PËR KËTË OE ËSHTË NENSHTRUAR NGA PERSONI JO I AUTORIZUAR. DUKE U BAZUAR NE LIGJET NË FUQI, INTERPRETIMET E KRPP DHE VENDIMET E OSHP LIDHUR ME KETE QËSHTJE, KY OE DUHET TË SHPALLET I PAPERGJEGJSHËM.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi ankimor duke u bazuar ne tarifat për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë (TPL) Të aprovuara nga BQK-ja jep sqarimet ne vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Tarifat BQK €</i>	<i>Çmimi ofruar nje vit €</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Përshkrimi</i>
3	TOJOTA– me Rimorkio ngark. Max 1180kg	2779	1999	TPL	1630	240.72	247.80 €	Plus 7.08 €	Ka ofertuar me çmim me të lartë prej 7.08 €

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifar 2 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me peshën në tonë, tarifa 1 deri 2 ton, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me një vlerë më te lartë prej 7.08.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 2

Pesha në tonë		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	0,5	152.00	27.36	179.36
0,50	1	168.00	30.24	198.24
1	2	204.00	36.72	240.72
2	3	254.00	45.72	299.72
3	5	305.00	54.90	359.90
5	7	355.00	63.90	418.90
7	10	454.00	81.72	535.72
10	15	610.00	109.80	719.80
Mbi	15	760.00	136.80	896.80

2 .Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin RENAULT eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	Emërtimi	Cm3	Viti	Lloji sigurimi	Pesh/KG	Tarifat e BQK	Çmimi ofruar nje vit	Diferenca	përshkrimi
8	RENAULT	2200	2000	TPL	2315	247.80	184.08	-63.72	Nuk jan zbatuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifor 1, ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm3 tarifa mbi 2701, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifor 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40

3 .Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin MERCEDES eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	Emërtimi	Cm3	Viti	Lloji sigurimi	Pesh/KG	Tarifat e BQK	Çmimi ofruar	Diferenca	Përshkrimi
1	MERCEDES	2200	200	TPL	2790	184.08	212.40	Plus 28.32	Ka ofertuar me çmim me të lartë

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifor 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm³ tarifa

1951 deri 2250, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me një çmim me të lartë prej 28.32 euro.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifor 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

4. Sa i përket pretendimit te OE ankues për automjetin MITSUBISH eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

	<i>Emertimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimi</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Tarifat e BQK</i>	<i>Çmimi ofruar</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Përshkrimi</i>
1	MITSUBISH	1100	2013	TPL	1003	100.30	87.32	-12.98	Nuk ka respektuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifor 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm3 tarifa 1101 deri 1300, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifor 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90

1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

Prandaj duke u bazuar ne llogaritjet dhe sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Ndërsa sa i përket vërejtjes se ne dosje të tenderit për këtë OE është nënshtruar nga personi jo i autorizuar. Duke u bazuar ne ligjet në fuqi, interpretimet e KRPP dhe vendimet e OSHP lidhur me këtë çështjeje, ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – konstaton se ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemi. Prandaj nga kjo qe u tha me lartë del se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigjeje në pretendimin 4.

Sa i përket pretendimit te operatorit ankues se Tek OE DUKAGJINI SHA i cili është klasifikuar si tenderues i pasuksesshëm janë evidentuar këto shkelje tek oferta e dhenë për sigurimet TPL për automjetet nga tabela PARAMASA PËR SIGURIMIN E AUTOMJETEVE për të cilave sipas specifikave teknike është dashur të ofertohej.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
6	Autoambulanca Peugeot	2198	2013	2086	COPE	1	TPL	184.08	552.24

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 184.08€, ndërsa bazuar ne tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

240.72€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë 1 deri 2 tone. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuara nga librezja e automjetit të ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>SASIA</i>	<i>Lloji sigurimit</i>	<i>ÇMIMI</i>	<i>SHUMA</i>
8	Renault	2200	2000	2315	COPE	1	TPL	184.08	552.24

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 184.08€, ndërsa bazuar ne tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

247.80€ me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë mbi 2701cm³. Të dhënat teknike për këtë automjet janë konfirmuar nga librezja e automjetit të ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Automjetet e QPS-së (Qendra për punë sociale)

	Përshkrimi	Cm ³	Viti	Pesh/KG	Njësia matëse	SASIA	Lloji sigurimit	ÇMIMI	SHUMA
1	Mitsubish	1100	2013	1003	COPE	1	TPL	87.32	261.96

OE për këto automjete ka ofertuar me çmim për njësi 87.32€, ndërsa bazuar ne tarifat e miratuara nga BQK për këtë lloj automjet duhet të ofertohej si në vijim:

100.30 me TVSH, tarife e aplikueshme për automjetet me kategorinë 1101 deri 1300cm³. Të dhënat teknike janë konfirmuara nga librezja e automjetit të ofruar nga AK si sqarime shtesë.

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi ankimor duke u bazuar ne tarifat për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë (TPL) Të aprovuara nga BQK-ja jep sqarimet ne vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	Emërtimi	Cm ³	Viti	Lloji sigurim	Pesh/KG	Tarifat e BQK	Çmimi i ofruar për një vit	Diferenca	Përshkrimi
1	Autoambulanca Peugeot	2198	2013	TPL	2086	184.08	184.08	0	Është respektuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifar 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm³ tarifa 1951 deri 2250, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri	Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0 750	50.00	9.00	59.00
751 900	60.00	10.80	70.80
901 1100	74.00	13.32	87.32
1101 1300	85.00	15.30	100.30
1301 1500	92.00	16.56	108.56
1501 1700	105.00	18.90	123.90
1701 1950	130.00	23.40	153.40
1951 2250	156.00	28.08	184.08
2251 2700	180.00	32.40	212.40

Mbi	2701	210.00	37.80	247.80
-----	------	--------	-------	--------

Sa i përket pretendimit të OE ankues për automjetin RENAULT eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

	<i>Emërtimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimi</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Tarifat e BQK</i>	<i>Çmimi ofruar në vit</i>	<i>Diferenca</i>	<i>përshkrimi</i>
8	RENAULT	2200	2000	TPL	2315	247.80	184.08	-63.72	Nuk janë zbatuar tarifat e BQK- së

Ky automjet hyn në kategorinë e grupit tarifar 1, ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm³ tarifa mbi 2701, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë shkelje të tarifave të miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

Sa i përket pretendimit të OE ankues për automjetin MITSUBISHI eksperti shqyrtues jep sqarimet në vijim.

	<i>Emertimi</i>	<i>Cm3</i>	<i>Viti</i>	<i>Lloji sigurimi</i>	<i>Pesh/KG</i>	<i>Tarifat e BQK</i>	<i>Çmimi ofruar</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Përshkrimi</i>
1	MITSUBISHI	1100	2013	TPL	1003	100.30	87.32	-12.19	Nuk ka respektuar tarifat e BQK-së

Ky automjet hyn ne kategorinë e grupit tarifar 1 ku tarifat e BQK-së duhet të llogaritet me cm³ tarifa 1101 deri 1300, prandaj pas llogaritjes del se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë respektuar tarifat e miratuara nga BQK.

Tarifat e BQK- së Grupi tarifar 1

Kapaciteti i motorit cm ³ ;prej-deri		Primi neto	TVSH 18%	Primi bruto
0	750	50.00	9.00	59.00
751	900	60.00	10.80	70.80
901	1100	74.00	13.32	87.32
1101	1300	85.00	15.30	100.30
1301	1500	92.00	16.56	108.56
1501	1700	105.00	18.90	123.90
1701	1950	130.00	23.40	153.40
1951	2250	156.00	28.08	184.08
2251	2700	180.00	32.40	212.40
Mbi	2701	210.00	37.80	247.80

Sqarim: të dhënat për kapacitetin e motorit janë vërtetuar edhe nga librezat e automjeteve të ofruara nga AK KK Drenas.

Ndërsa sa i përket vërejtjes se në dosje të tenderit për këtë OE është nënshtruar nga personi jo i autorizuar. Duke u bazuar në ligjet në fuqi, interpretimet e KRPP dhe vendimet e OSHP lidhur me këtë çështjeje, ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – konstaton se ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemi. Prandaj duke u bazuar në llogaritjet dhe sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik “Sigma interalbenian vienna Insurance Group sh.a-Dega Kosovë-Prishtinë, përmes parashtrësës me shkrim të datës: 09.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues KK- Gillogoc përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues si dhe ekspertja profesionale e prokurimit ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Zhuniqi deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertës pasi të gjitha pikat ankimore janë marre të bazuar të gjithë OE ofertues duke përfshirë edhe OE fitues të cilat kanë shkelur tarifat e BQK-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Gllareva deklaroj: Ne si Autoriteti Kontraktues komisioni i vlerësimit ka shqyrtues ofertat e OE-ve, OE fitues ka qenë me çmim më të ulët dhe kriteri ka qenë çmimi më i ulët dhe e kemi shpallur fitues.

